

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5234 Prot.

Rrogozhinë, më 18 .12.2024

R A P O R T

**MBI VENDIMET E MARRA NGA KËSHILLI BASHKIAK PËR PERIUDHËN
JANAR – NËNTOR 2024, VENDIMET TË CILAT NUK JANË KONFIRMUAR
LIGJËRISHT NGA PREFEKTI I QARKUT TIRANË, SI DHE ZBATUESHMËRIA E
KËTYRE VENDIMEVE NGA ANA E ADMINISTRATËS SË BASHKISË**

Të nderuar Këshilltarë ,

Po ju paraqesim në vijim një raport të përmbledhur mbi Vendimet dhe mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Bashkiak Rrogozhinë për periudhën Janar - Nëntor 2024, vendimet e pakonfirmuara ligjërisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë dhe zbatueshmërinë e këtyre vendimeve nga ana e Administratës së Bashkisë si më poshtë :

• **VITI 2024**

VKB të mbledhjes datë 29.01.2024 (Procesverbal nr.1)

- Vendim nr .1. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Dhjetor 2023 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
- Vendim nr .2. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i pushtetit vendor.
- Vendim nr .3. Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e bashkisë Rrogozhinë.
- Vendim nr .4. Për miratimin e fondit për zbatimin e projektit, “Tungjatjeta jetë, shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar.

VKB të mbledhjes datë 12.02.2024 (Procesverbal nr.2)

- Vendim nr .5. Për miratimin në parim të kërkesës për bashkëfinancim për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare dhe kopshtit Spille, Njësia Administrative Kryevidh.
- Vendim nr .6. Për miratimin në parim të kërkesës për bashkëfinancim për rikonstrukcion të banesave, Bashkia Rrogozhinë.



VKB të mbledhjes datë 27.02.2024 (Procesverbal nr.3)

- Vendim nr .7. Për pranimin e dorëheqjes nga mandati i këshilltarit të z. Ferdi Avdiu.
- Vendim nr .8. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
- Vendim nr .9. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i pushtetit vendor.
- Vendim nr .10. Për dhënien e ndihmës financiare të familjes së ish këshilltarit të ndjerë z. Bajazit Thaçi.
- Vendim nr .11. Për dhënien e mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak znj. Merilin Saraçi.

VKB të mbledhjes datë 26.03.2024 (Procesverbal nr.4)

- Vendim nr .12. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
- Vendim nr .13. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2024 nga fondi i pushtetit vendor.
- Vendim nr .14. Për ngritjen e komisionit këshillimor për dhënien e titujve të nderit për Bashkinë Rrogozhinë.
- Vendim nr .15. Për miratimin e kërkesës me efekt financiar prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh për familjen e z. Fatbardh Shefqet Sokoli.

VKB të mbledhjes datë 02.04.2024 (Procesverbal nr.5)

- Vendim nr .16. Për miratimin e një ndryshimi të VKB-së Nr.34 datë 27.12.2023 “Miratimi i paketës fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë”.

VKB të mbledhjes datë 25.04.2024 (Procesverbal nr.6)

- Vendim nr .17. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Mars 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .
- Vendim nr .18. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2024 nga fondi i pushtetit vendor.
- Vendim nr .19. Për miratimin e Plan Masash, “Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhen të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret”.
- Vendim nr .20. Për miratimin e shtesës, për kushtet e punës të specialistëve të sektorit IT në Bashkinë Rrogozhinë.



Vendim nr .21. Për miratimin e rregullores, “Për titujt vendorë të nderit në Bashkinë Rrogozhinë, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre”.

Vendim nr .22. Për miratimin e Programit të Transparencës së Bashkisë Rrogozhinë.

Vendim nr .23. Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile.

VKB të mbledhjes datë 08.05.2024 (Procesverbal nr.7)

Vendim nr .24. Për dhënie premio për ekipin Egnatia për zhvillimin e aktivitetit sportiv, finalist i kupës së Shqipërisë dhe finalist i parë i “Final four”.

VKB të mbledhjes datë 03.06.2024 (Procesverbal nr.8)

Vendim nr .25. Për dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak z. Isa Halili.

Vendim nr .26. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Prill 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .27. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .28. Për dhënien e ndihmës së menjëhershme ekonomike për familjet në nevojë.

Vendim nr .29. Për emërtimin e një rruge në territorin e Bashkisë Rrogozhinë.

Vendim nr .30. Për një ndryshim të VKB-së Nr.34, datë 27.12.2023 ‘Miratim i Paketës Fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë’, i ndryshuar me VKB-në Nr.16, datë 02.04.2024 “Për miratimin e një ndryshimi të VKB-së Nr.34, datë 27.12.2023 ‘Miratim i Paketës Fiskale viti 2024 për Bashkinë Rrogozhinë’ “.

Vendim nr .31. Për shtimin e punonjësve sezonalë plazhi (me kontratë) për periudhën Qershor - Gusht 2024”.

VKB të mbledhjes datë 26.06.2024 (Procesverbal nr.9)

Vendim nr .32. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Maj 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .33. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .34. Për shpalljen e emergjencës në rezervuarin e Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryevidh.

Vendim nr .35. Për një ndryshim në vendimin nr.37, datë 27.12.2023, ‘Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së Bashkisë për vitin 2024’ “, me qëllim përfshirjen në këtë vendim për caktimin e nivelit të pagave të Punonjësve të Policisë Bashkiake Rrogozhinë.



Vendim nr .36. Për miratimin e projektit, “Organizim eventit muzikor dhe humoristik në qytetin tonë për periudhën e stinës së verës datë 28 Korrik 2024”.

VKB të mbledhjes datë 19.07.2024 (Procesverbal nr.10)

Vendim nr .37. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Qershor 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .38. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

VKB të mbledhjes datë 26.09.2024 (Procesverbal nr.11)

Vendim nr .39. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Korrik 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .40. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .41. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .42. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Gusht 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .43. Për miratimin e kërkesës Nr. 2107, për mbështetje financiare në lidhje me rehabilitimin e rezervuarit të Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryevidh”.

Vendim nr .44. Për pranimin e dorëheqjes nga mandati i Këshilltarit të znj. Fatbardha Sina.

Vendim nr .45. Për miratimin e nismës së Aleancës së Grave Këshilltare, për mbështetjen financiare të projektit “Një rrugëtim drejt të ardhmes”.


Vendim nr .46. Për miratimin e kërkesës së z. Xhelal Tosku për sponsorizimin e botimit të librit.

Vendim nr .47. Për miratimin e fondit të akorduar për mbulimin e rritjes së nivelit të pagave”.

Vendim nr .48. Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të bashkisë Rrogozhinë.

VKB të mbledhjes datë 30.10.2024 (Procesverbal nr.12)

Vendim nr .49. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shtator 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .



Vendim nr .50. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

Vendim nr .51. Për miratimin e Planit Social të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2025-2028.

Vendim nr .52. Për miratimin e kërkesës së z. Haziz Jashar Kashari për ndihmë të menjëhershme financiare.

Vendim nr .53. Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.38, datë 27.12.2024 për buxhetin e bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024.

Vendim nr .54. Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkuar midis Bashkisë Rrogozhinë dhe ASHK-së.

VKB të mbledhjes datë 20.11.2024 (Procesverbal nr.13)

Vendim nr .55. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Tetor 2024 nga fondi i Bllok – Ndihmës 6% .

Vendim nr .56. Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Nëntor 2024 nga fondi i pushtetit vendor.

**PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË KËSHILLIT QË NUK JANË KONFIRMUAR
LIGJËRISHT NGA PREFEKTI I QARKUT TIRANË**

Këshilli Bashkiak Rrogozhinë përgjatë periudhës Janar - Nëntor 2024 është thirrur për mbledhje 14-herë, dhe është mbledhur mbështetur dhe në procesverbalet 13 herë, pasi mbledhja e thirrur me datë 07.08.2024 nuk u arrit të zhvillohej për shkak mungesës së kuorumit të nevojshëm. Këshilli Bashkiak që nga data 28.10.2022 transmeton LIVE mbledhjet e tij në faqen zyrtare të Këshillit në rrjetin social Facebook emërtuar “Këshilli Bashkiak Rrogozhinë”, dhe për vitin 2024 në këtë faqe gjenden të transmetura LIVE 10 mbledhje. Mbledhjet janë shtyrë në 4 (katër) raste nga data e njoftuar, më kokretisht:

1. Mbledhja e thirrur në datë 26.02.2024 shtyhet për datë 27.02.2024,
2. Mbledhja e thirrur në datë 01.04.2024 shtyhet për datë 02.04.2024,
3. Mbledhja e thirrur në datë 24.04.2024 shtyhet për datë 25.04.2024,
4. Mbledhja e thirrur në datë 29.10.2024 shtyhet për datë 30.10.2024.

Që nga mbledhja e datës 26.06.2024 sipas ndryshimeve ligjore për verifikim ligjor në Institucionin e Prefektit të Qarkut Tiranë përcillen vetëm aktet me karakter normativ ndërsa aktet me karakter individual hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe nuk përcillen drejt Prefektit të Qarkut për verifikim ligjor.

Për periudhën Janar - Nëntor 2024 janë marrë gjithsej 56 vendime nga Këshilli Bashkiak, prej të cilave 39 (akte me karakter normativ) janë përcjellë për verifikim ligjor pranë Institucionit të



Prefektit të Qarkut Tiranë nga ku 33 prej tyre janë gjetur në përputhje me aktet Ligjore e nënligjore në fuqi.

Për 6 (gjashtë) vendimet e tjera të pakonfirmuara ligjërisht, Prefekti shprehet si më poshtë :

1 - Vendimi nr .24. datë 08.05.2024 Për dhënie premio për ekipin Egnatia për zhvillimin e aktivitetit sportiv, finalist i kupës së Shqipërisë dhe finalist i parë i "Final four".

Nuk konfirmohet pasi bie në kundërshtim me pikën 4 të nenit 27 të ligjit nr.79/2017 "Për Sportin", i ndryshuar.

2 - Vendim nr .34. datë 26.06.2024 "Për shpalljen e emergjencës në rezervuarin e Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryevidh".

Nuk konfirmohet pasi objekti i vendimit nuk është kompetencë e Këshillit Bashkiak referuar Ligjit nr.13/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 54 si dhe Ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 39,40 e vijues.

3 - Vendimi nr .36. datë 26.06.2024 Për miratimin e projektit, "Organizim eventit muzikor dhe humoristik në qytetin tonë për periudhën e stinës së verës datë 28 Korrik 2024".


Nuk konfirmohet pasi fondi i përcaktuar në këtë vendim është i parashikuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak për Buxhetin e vitit 2024, dhe mund të përdoret rast pas rasti sipas kriterëve ligjore përkatëse, si dhe Këshilli Bashkiak miraton rastet e parashikuara në nenin 44, pika a të Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

4 - Vendimi nr .45. datë 26.09.2024 "Për miratimin e nismës së Aleancës së Grave Këshilltare, për mbështetjen financiare të projektit "Një rrugëtim drejt të ardhmes".

Nuk konfirmohet referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar si dhe ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" pasi objekti i vendimit nuk ka referencë ligjore të përcaktuar si dhe as relacion shpjegues dhe arsyetues të shoqëruar me dokumentacion për vendimmarrjen në fjalë. Përsa i përket fondit, sipas përcaktimit në vendim është i parashikuar në buxhetin vjetor të miratuar të bashkisë.

5 - Vendimi nr.53, datë 30.10.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.38, datë 27.12.2024 për buxhetin e bashkisë Rrogozhinë për vitin 2024".

Nuk konfirmohet referuar nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor", i ndryshuar pasi nuk jemi në rastin e një rishpërndarje fondi ndërmjet programesh por miratim i një fondi të parashikuar në buxhetin e vitit 2024.



6 - Vendimi nr.54, datë 30.10.2024, "Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nëshkuar midis Bashkisë Rrogozhinë dhe ASHK-së".

Nuk konfirmohet pasi nuk është kompetencë e këshillit bashkiak miratimi i marrëveshjeve të nënshkuara, por është detyrë e kryetarit të bashkisë, kjo referuar nenit 9 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, përcaktuar dhe në nenin 10 të kësaj marrëveshje.

**ZBATUESHMËRIA E VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK RROGOZHINË
PERIUDHA JANAR - NËNTOR 2024**

Nr	Vendim i Këshillit Bashkiak, Nr / datë / titull	Statusi i VKB - së I pazbatuar / Zbatuar pjesërisht	Shënime
1	Vendim nr .3, datë 29.01.2024 "Për përcaktimin e disa kundravajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e bashkisë Rrogozhinë".	Zbatuar pjesërisht	Zbatohet aktualisht dhe deri në Dhjetor të vitit 2024.
2	Vendim nr .4, datë 29.01.2024 "Për miratimin e fondit për projektin, "Tungjatjeta jetë, shërbim lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuar".	Zbatuar pjesërisht	Zbatohet aktualisht dhe deri në Dhjetor të vitit 2024.
3	Vendim nr .5, datë 12. 02. 2024 "Për miratimin në parim të kërkesës për bashkëfinancim për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare dhe kopshtit Spille, Njësia Administrative Kryevidh".	I Pazbatuar	Deri në këtë moment nuk është miratuar fondi nga Ministria përkatëse.
4	Vendim nr .6, datë 12.02.2024 "Për miratimin në parim të kërkesës për bashkëfinancim për rikonstruksion të banesave, Bashkia Rrogozhinë".	Zbatuar pjesërisht	Miratuar fondi nga Ministria përkatëse pritët shpallja e firmës ndërtuese nga njësia e prokurimit.
5	Vendim nr .10, datë 27.02.2024 "Për dhënien e ndihmës financiare të familjes së ish këshilltarit të ndjerë z.Bajazit Thaçi".	I Pazbatuar	.
6	Vendim nr .19, datë 25.04.2024 "Për miratimin e Plan Masash, 'Për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve masat që duhen të merren për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave bashkiake nga zjarret' ".	Zbatuar pjesërisht	Është ngritur shtabi i emergjencave në bashki dhe në bazë Nj. A .
7	Vendim nr .29, datë 03.06.2024 "Për emërtimin e një rruge në territorin e Bashkisë Rrogozhinë".	I Pazbatuar	.
8	Vendim nr .43, datë 26.09.2024 "Për miratimin e kërkesës Nr. 2107, për mbështetje financiare në lidhje me rehabilitimin e rezervuarit të Domen, fshati Domen, Njësia Administrative Kryevidh".	Zbatuar pjesërisht	Ka nisur procesi është në fazat fillestare, është përcjellë praktika drejt AKMC-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Të gjithë VKB-të e tjera të cilat janë konfirmuar ligjërisht nga Prefekti i Qarkut Tiranë nuk janë evidentuar në tabelën e mësipërme pasi janë zbatuar nga ana e Administratës dhe sektorëve të cilëve ju është ngarkuar për zbatim Vendimi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin .

Konceptoi ,
Sekretari i Këshillit
ERVIS SHERA

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT

ERIND TOSKU

